



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 683/5 prot.

Tiranë më 05.07.2019

REKOMANDIM

Nr. 23, datë 05. 7.2019

PËR KONTROLLUESIN KREDO.AL

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Kredo.al*",

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 178, datë 31.05.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "*Kredo.al*", me objekt:

- Verifikim i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga një shtetas, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

Hetimi administrativ pranë kontrolluesit, u fokusua në trajtimin e ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga një shtetas ( ), i cili denoncon kontrolluesin lidhur me përpunimin/përhapjen e të dhënave të tij, gjithashtu dhe në verifikimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi gjatë ushtrimit të aktivitetit.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "*Kredo.al*", konstaton se:

1. Kontrolluesi "*Kredo.al*" është një shoqëri Financiare Mikrokredie dhe ushtron veprimtarinë në fushën e Mikrokredisë dhe këshillimit të klientëve të saj në fushën e kredidhënie-marrjes. Në kuadër të marrëdhënies së punës kontrolluesi mbledh dhe

përpunon disa kategori të të dhënave personale dhe sensitive, për subjektet e të dhënave personale “Klientë”, “Kandidatëve për punë” dhe “Punonjës”. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Në kuadër të trajtimit të ankesës, kontrolluesi “*Kredo.al*” ka kontaktuar me qëllim për të ofertuar shërbimin si lidhur me identifikimin/gjetjen e një zyre. Gjithashtu kontrolluesi ka vlerësuar që ky shërbim ka një vlerë të konsiderueshme dhe për këtë vlerë do të duhej të ofertohej një minimum prej 3 subjektësh për të marrë një vendim të duhur për kompaninë.

i është kërkuar me email nga kontrolluesi të dërgojë në mënyrë më të strukturuar ofertën sipas fazave të projektit dhe nëpërmjet të njëjtit email janë fituar dhe dy subjekte të tjera. Pas krahasimit të ofertës ekonomike kontrolluesi ka vlerësua si fitues një subjekt tjetër dhe jo subjektin

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në konceptin e mbrojtjes së të dhënave personale nuk konstatohet që procedura e ndjekur nga kontrolluesi lidhur me shërbimin e kërkuar të jetë kryer në shkelje të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Ky ligj nuk ofron mbrojtje për përpunimin/përhapjen e të dhënave në kuadër të përpunimit të tyre si subjekte tregtare. Të dhënat e subjekteve tregtare nuk konsiderohen si të dhëna personale dhe përpunimi i të dhënave të tyre nuk kufizohet nga ligji.

3. Në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale gjatë ushtrimit të aktivitetit u konstatua se kontrolluesi “*Kredo.al*”, gjatë procesit të përpunimit të të dhënave për kategorinë e subjekteve kandidatë për punë, nuk ka respektuar parimin e mbrojtjes së të dhënave personale lidhur kohën e ruajtjes së të dhënave personale. Të gjitha të dhënat për këtë kategori subjektësh përpunohen që nga koha e fillimit të aktivitetit të kontrolluesit pavarësisht se këto subjekte janë klasifikuar si të papërshtatshëm për të fituar vendin e punës.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në frymën e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, kontrolluesi ka detyrim të përpunojë të dhënat personale për aq kohë sa ekziston qëllimi për të cilin janë grumbulluar dhe përpunuar (neni 5/1/d) dhe në momentin që qëllimi ka përfunduar të realizojë shkatërrimin e tyre, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i të dhënave konsiderohet i paligjshëm.

4. Konstatohet se “Politika e Privatësisë” e publikuar në faqen online [www.kredo.al](http://www.kredo.al), nuk është plotësisht në përputhje me parashikimet e nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

“Politika e Privatësisë”, duhet të parashikojë informacion lidhur me të gjitha proceset përpunuese që kryen kontrolluesi, duke reflektuar zbatimin e parimeve të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, dhe



detyrimet specifike në referim të akteve nënligjore të miratuara nga Komisioneri që referojnë këto procese përpunuese.

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

Referuar formatit të “Politikës së Privatësisë” të publikuar në faqe, në vijim po ju referojmë disa nga problematikat e konstatuara, të cilat kurrsesi nuk janë definitive pasi mbetet e nevojshme një analizim i mëtejshëm dhe tërësor nga ana juaj.

Konkretisht i referohemi këtyre paqartësive dhe pasaktësive:

- Referuar paragrafit 1.1, të verifikohet legjitimimi i përpunimit të kategorisë së të dhënave “statusi politik i personit”. Zyra e Komisionerit nisur nga praktika e deritanishme vlerëson se është e tepërt dhe në tejkalim të qëllimit të përpunimit;
- Referuar paragrafit 1.2, të vlerësohet domosdoshmëria ose jo e përpunimit të të dhënave sensitive të aplikantëve dhe klientëve, mbështetur në bazën ligjore specifike që e legjitimon këtë përpunim. Nëse nuk janë të nevojshme atëherë nuk duhen përpunuar;
- Referuar paragrafit 1.3, të parashikohen konkretisht se kush janë palët e treta. Kjo i jep mundësi subjektit të të dhënave personale të njihet me kontrollues të tjerë të mundshëm që përpunojnë të dhënat e tij personale dhe gjithashtu i jep mundësi të ushtrojë të drejtat e tij;
- Referuar paragrafit 1.4, vlerësojmë se ky parashikim vjen në kundërshtim me parimin e mjaftueshmërisë të dhënave personale;
- Referuar paragrafit 2.1, qëllimet e përpunimit duhet të reflektojnë çdo proces përpunues;
- Referuar paragrafeve 3.1 dhe 3.2, është e nevojshme të specifikohen vendet ku ruhen të dhënat dhe kompanitë që e ofrojnë shërbimin (në cilësinë e përpunuesit) me qëllim dhënien e mundësisë subjektit të të dhënave për të kontaktuar dhe ushtruar të drejtat e tyre;
- Referuar paragrafit 3.3, vlerësojmë se afatet e ruajtjes duhet të jenë të përcaktuara në mënyrë koncize, për çdo proces përpunues, dhe nuk mund të tejkalohen. Gjithashtu duhet të jepet informacion se çfarë ndodh më pas me të dhënat personale. Nëse të dhënat shkatërrohen duhet specifikuar nëse kjo kryhet nga ju apo nga ndonjë kompani tjetër e kontraktuar për këtë shërbim (në cilësinë e përpunuesi), dhe mënyrën e shkatërrimit;
- Referuar paragrafit 5.1, të specifikohen se kush janë palët e treta, pasi marrësit e të dhënave në asnjë rast nuk mund të jenë të pa specifikuar;
- Referuar paragrafit 5.2, në rastet e referuara duhet të parashikohet detyrimi i Kredo.al, në cilësinë e kontrolluesit, për të informuar paraprakisht subjektet e të dhënave personale.

5. Kontrolluesi **"Kredo.al"** ka përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Nga analizimi i përmbajtjes së njoftimit rezultoi se kontrolluesi nuk e kishte kryer përditësimin për ndryshim të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave, sa i përket deklaramit në rubrikën 3, të formularit të njoftimit "*Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen*" për kategorinë kandidatët për punë. Në rubrikën 4, të formularit "*Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen*" për të dhënat numër telefoni, e-mail, të dhënat për formimin diplomat, adresa. Në rubrikën 5, të formularit "*Të dhënat sensitive që përpunohen*" për të dhënat sensitive shëndeti dhe gjendja penale. Në rubrikën 9, të formularit "*Mjetet e përpunimit të të dhënave*" për përpunimin e të dhënave në mënyrë mekanike/manuale.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep ligji.

6. Kontrolluesi **"Kredo.al"** në kuadër të garantimit të sigurisë së ambienteve ku ushtron veprimtarinë ka instaluar një sistem kamerash CCTV. Në "Rregulloren e Sigurisë Fizike" dhe në "Politikën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale", ka parashikuar se afati i ruajtjes së pamjeve të kamerave është 3 muaj,

Zyra e Komisionerit vlerëson se, tejkalimi i afatit dy muaj për ruajtjen e pamjeve të kamerave është në kundërshtim me Udhëzimin nr.3, datë 05/03/2010 mbi "Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar, në të cilin parashikohet një afat maksimal 2 muaj.

Gjithashtu, kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa të mjaftueshme në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Zyra e Komisionerit vlerëson se, në referim të kreut IV, të Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018, për "Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha", është e nevojshme, që në cilësinë e kontrolluesit, me qëllim garantimin efektiv të detyrimeve ligjore dhe zbatimit të tyre në praktikë, të ndërmerren masa në kuadër të trajnimit të stafit që ka akses dhe përpunon të dhëna personale.

7. Kontrolluesi **"Kredo.al"** bën pjesë në kategorinë e kontrolluesve të mëdhenj në kuptim të Udhëzimit të Komisionerit nr. 47, datë 14.09.2018, për "Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha".

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të natyrës së veçantë të aktivitetit që ushtron dhe masave të shtuara të sigurisë që ky i fundit kërkon në aspekt të mbrojtjes



së të dhënave, kontrolluesi në fjalë, me qëllim garantimin e këtij niveli sigurie duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin 48 datë 14.09.2018 "Për certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre" duke certifikuar sistemin e sigurisë së menaxhimit të të dhënave në përputhje me kërkesat e këtij të fundit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin (datë 25.06.2019), si dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", në datën 02.07.2019, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit, është mbajtur seanca dëgjimore.

Në seancën dëgjimore përfaqësuesit e kontrolluesit nuk patën kundërshtime dhe parashtruan se janë duke punuar në drejtim të rikuperimit të mangësive të konstatuara.

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit me grupin e kontrollit administrativ dhe reagimin e tij për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, informimin e subjekteve të të dhënave, sigurinë e të dhënave personale dhe ndalon mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 18, 21, 27, 29, 30, 31 pika 1 gërma a/1 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

#### **REKOMANDOJ:**

1. Kontrolluesi "**Kredo.al**", të realizojë shkatërrimin e të dhënave të kandidatëve për punë, të cilat janë klasifikuar si të papërshtatshëm për të fituar vendin e punës dhe janë ruajtur në tejkalim të qëllimit të përpunimit.
2. Kontrolluesi "**Kredo.al**", në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të marrë masa për përditësimin e politikave të privatësisë në faqen online [www.kredo.al](http://www.kredo.al).
3. Kontrolluesi "**Kredo.al**", në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të reflektojë në përmbajtje të "Politikës së Privatësisë", të gjitha konstatimet e evidentuara nga Zyra e Komisionerit, të analizojë në tërësi përmbajtjen e saj, dhe në të njëjtën kohë të ketë në vëmendje përmbushjen në vazhdim të detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale.
4. Kontrolluesi "**Kredo.al**", në zbatim të neneve 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të kryej përditësimin për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë.
5. Kontrolluesi "**Kredo.al**", në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit, për të gjitha ndryshimet e mundshme në përpunimin e të dhënave personale në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.

6. Kontrolluesi "**Kredo.al**", në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të marrë masa për të ndryshuar në "Rregulloren e Sigurisë Fizike" dhe në "Politikën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale", afatin për ruajtjen e pamjeve të kamerave duke vendosur një afat në përputhje më parashikimin në Udhëzimin e Komisionerit nr.3, datë 05/03/2010 mbi "Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar.
7. Kontrolluesi "**Kredo.al**", me qëllim garantimin efektiv të detyrimeve ligjore dhe zbatimit të tyre në praktikë, të ndërmarrë masa në kuadër të trajnimit të stafit që ka akses dhe përpunon të dhëna personale.
8. Kontrolluesi "**Kredo.al**", për shkak të natyrës së veçantë të aktivitetit që ushtron, duhet të marrë masat e nevojshme në lidhje me certifikimin mbi sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre.
9. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimit të parashikuar në pikat 1,2,4,6 dhe 7 të këtij rekomandimi, brenda 30 ditëve, ndërsa për pikën 8 brenda 90 ditëve nga marrja dijeni e aktit.
10. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 05/7/2019

**KOMISIONERI**  
**Besnik Dervishi**

